



07/462 Nr. 19178 Dt. 07.02.25



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nga: Drejtoria Gjeodezisë dhe Kadastër


Tema: Raport për vitin 2024

Data: 31 Dhjetor 2024



Gjatë kësaj periudhe si drejtoria kemi pranuar 24177 kërkesa në kuadër të sektorit të gjeodezisë dhe kadastrit: si kontratat e shitblerjes, kontratat e dhurimit, aktgjykimet, aktvendimet, lista poseduese, kopje të planit, ndarjet e parcelave, bashkimet e parcelave, regjistrimet e objekteve dhe pjesëve të objekteve. Nga këto lloje të lëndëve si numër:

- 23536 kërkesa janë miratuar,
- 76 janë në proces të sipër,
- 408 kërkesa është refuzuar
- 102 janë të pezulluar
- 49 janë të anuluar për shkaqe të gabime teknike.¹



¹ Këto të dhëna janë marrë nga sistemi zyrtar Intranet dhe paraqesin pasqyrën e lëndëve deri më datën 31.12.2024.

Në këtë periudhë nga shërbimet të lartë përmendura janë grumbulluar të hyra prej 367,926 euro², cili është llogaritur ne përqindjen 73.58 e te hyrave kësaj drejtorie. Mos realizimi i të hyrave të tërësishëm ka ndodhur për shkak se është ndryshuar në muajin qershor Udhëzimi Administrativ-UA nga Agjensioni Kadastral i Kosovës-AKK me të cilën janë zvogëluar tarifat dhe shërbimet kadastrale.

Aktivitetet më të rëndësishme që janë marrë në këtë periudhë janë:

- **Legalizimi:** Janë regjistruar 236 vendimet të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor sipas ligjit për ndërtimet pa leje. Dhe të gjitha këto objekte tani janë të evidentuara në regjistrat kadastrale, ku për secilën ekzistojnë certifikata të pronës.
- **Shpronësimet:** Gjatë afatit raportues janë përfunduar projektet të shpronësimit edhe disa janë të përfundim sipër:
 - i. **Varrezat e Qytetit** – Pas shpalljes nga Komuna e Prizrenit si Interes i përgjithshëm Publik, është proceduar në Qeveri ky vendim, i cili vendim është miratuar dhe janë zhvilluar procedurat e shpronësimit marrjen e Vendimi përfundimtar. Si komuna kemi pranuar vlerësimin nga Ministrisë së Financave dhe Transfereve, ku tani jemi ne pritje, qe te behet ekzekutimi i pagesës nga ana e Drejtorisë se Financave, ku pas pagesës prona e lartcekur do te bartet ne emër te Komunës se Prizrenit, qe e njëjta te shërbej për shërbimet funerale. Varrezat e Qytetit si projekt ka përfunduar me datës 11.09.2024 dhe është realizuar bartje e pronësisë në emër të Komunës së Prizrenit.
 - ii. **Objekti ish ndërmarrjes LIRIA** - Krijimi i hapësirave për lëvizshmëri në trafik dhe për këmbësor e cila përfshinë rrënimin e objektit që shtrihet në pjesën e parcelës 4792-0 ZK Prizren (NTSH 'Liria'), po ashtu edhe për këtë ngastër kadastrale, është zhvilluar procedura e shpronësimit është marre vendimi përfundimtar, mirëpo jemi në pritje të faturës nga AKP-ja, në mënyrë që të realizohet pagesa dhe prona të bartët në emër të Komunës së Prizrenit. Rrënimi i objektit të NTSH 'Liria' ka përfunduar dhe tani ka filluar realizimi i projektit nga ana e Komunës.

² Këto të dhëna janë të datës 30.11.2024 të dërguara nga Drejtoria e Financave.

Ndërsa ende në procedurë janë këto projekte të shpronësimit ku për të cilat janë përpiluar projektet dhe elaboratet kadastral:

1. Realizimi projektit të TEA's deri te kryqja ne autostrada
2. Lidhja e rrugës nga lagjja Tusuz deri ne lagjen Bajram Curr
3. Realizimin e parkingut nëntokësor përball Komunës së Prizrenit.

Piketimet: Gjatë afatit të raportues sipas kërkesave të Drejtorive janë kryer piketimet e rrugëve, objekteve komunale dhe hapësirave publike.

Matjet Gjeodezike: Janë bërë matjet ne teren sipas kërkesave te drejtorive për inqizimet e gjendjeve faktike dhe projektet te cilat janë kërkuar nga drejtorit përkatëse.

- Janë bere matjet e objekteve sipas kërkesave te Drejtorisë se Shëndetësisë dhe për Drejtorin e Arsimit për legalizimin e objekteve dhe te cilat pas vendimit përkatës do te evidentohen ne regjistrat kadastrale.
- Kane kryer matjet rreth uzurpimeve ne pronat komunale nga zyrtaret e Sektorit te Gjeodezisë.